

Datë: 22 Nëntor 2016

Nr.Prot.051/B/16

## KONKLUZIONE

NGA

### KËSHILLIMI PUBLIK I DOKUMENTIT

**“Draft doumenteve të analizës së tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile”**

Draft dokumentet e analizes së tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile janë përgatitur në përputhje me nenin; 10, paragrafi 5, neni 31, paragrafët 1) dhe 3) nën-paragrafi 3.3) dhe nenin 79 paragrafi 2) i Ligjit Nr.04/L-109 për Komunikimet Elektronike (*tutje referuar si – LKE*), si dhe neni 3 paragrafët 1), 3) dhe 4) neni 4 paragrafi 3.13) e Rregullorës për analizat e tregut, të cilët e obligojnë ARKEP-in që të kryej analizat e tregut për të përcaktuar ndërmarrjet me Fuqi të Ndjeshme në Tregjet përkatëse (*tutje referuar si - FNT*) dhe konform gjetjeve nga analiza të vendosë detyrimet/obligimet ndaj ndërmarrjeve në fjalë.

Me vendimin Nr.848 (*Ref. Nr.Prot.024/B/16; dt.29/07/2016*) Bordi i ARKEP ka miratuar fillimin e këshillimit publik, i cili ka zgjatur nga data 01 Gusht 2016 deri më datë 16 shtator 2016<sup>1</sup>.

Gjatë periudhës së këshillimit publik komentet i kanë dërguar operatorët Telekomi i Kosovës SH.A (*tutje referuar si – TK*) dhe IPKO Telecommunications LLC (*tutje referuar si – IPKO*);

- 1) **Komentet e TK;** janë dërguar më datë; 16/09/2016 (*Ref. Shkresa/e-maili i datës 16 shtator 2016, 15:58 PM, Nr.Prot.770/2/16*), të cilat nuk kanë të bëjnë në mënyrë specifike me gjetjet e raportit të Analizës së tregut përkatësisht ndonjë dispozitë të draft vendimeve përfshirë këtu edhe detyrimet rregullatore të propozuara për t’u imponuar operatorëve me fuqi te ndjeshme në treg;
- 2) **Komentet e IPKO-së;** janë dërguar më datë; 07/09/2016 (*Ref .Nr.Prot.753/2/16*), të cilat kryesisht kanë qenë komente lidhur me referencën ligjore për inicimin e analizës së tregut, si dhe propozimi për ulje më të ndjeshme të tarifave të propozura në “glide path”.

---

<sup>1</sup> Vendimi ka specifikuar datën 07 Shtator 2016, megjithatë Bordi i ARKEP me qëllim të lejimit të kohës shtesë për palët e interesit në dhënien e komenteve të tyre ka zgjatur afatin e këshillimit deri më datë 16 Shtator 2016.

## *Përmbledhje lidhur me komentet e operatorëve dhe propozimi i ARKEP*

ARKEP ka shqyrtuar komentet e paraqitura nga operatorët dhe ka vërejtur se shumica e tyre nuk kanë qenë të fokusuar në çështje konkrete, megjithatë u ka dhënë përgjigje këtyre komente, të cilat janë paraqitur në shtojcë e këtij dokumenti.

Si përmbledhje e përgjigjeve mund të konkludojmë se propozimi i dalë nga *“Analiza e tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile”* mbetet i qëndrueshëm, pasi që operatorët nuk kanë dhënë argumente bindëse për ta ndryshuar këtë. Kësaj ia shtojmë faktin se modeli i propozuar nga ARKEP *“glide path”* është në nivelin e mesëm krahasuar me propozimet e dhëna nga dy operatorët. Gjithashtu ky propozim konsiderohet të jetë në funksion të ruajtjes së stabilitetit të tregut duke u dhënë mundësi operatorëve t’u përshtaten kushteve të reja, dhe t’u shmangen rrezikut të çrregullimit të tregut që do të mund të vinte qoftë nga një rënie e ngadaltë apo nga një rënie drastike e tarifës.

Është praktikë standarde e rregullatorëve që të përdorin *“glide path”* me rastin e rregullimit të reduktimit të tarifave të terminimit për një periudhë të caktuar kohore, gjithashtu mbetet në diskrecion të rregullatorit të përcaktoj elementet për *“glide path”* si: kohzgjatja, norma e zbritjes, numri i periudhave, etj.

Për më tepër, rregullorja 2015/2352<sup>2</sup> e Komisionit European ka përcaktuar tavanin e tarifës së terminimit të thirrjeve mobile 1.14 €cent për minut, e cila pritet të arrihet në Kosovës pas aplikimit të modelit të përshkallëzimit gradual pas 1.5 vitesh.

Nga këndvështrimi i ARKEP, të gjithë akterët aktiv në tregun e komunikimeve elektronike funksionojnë në një ambient të barabartë, bazën e të cilit e krijon Ligji dhe në këtë kontekst Autoriteti i trajton njëjtë pavarësisht formave të pronësisë.

Nga mungesa e kodit shtetëror ndikohen të gjithë operatorët, prandaj ARKEP nuk do të leshohet në lehtësirat eventuale që operatorëve mund t’iu vijnë nga përdorimi i kodeve shtetërore të vendeve tjera pasi që propozimi për rregullimin e tarifave është vetëm për trafikun e origjinuar benda vendit.

Pas shqyrtimit të komenteve të prezantuara nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE), Bordi i Autoritetit në mbledhjen 11-të me radhë të mbajtur me datën; 31 Tetor dhe 02 Nëntor 2016, ka miratuar; **dokumentet e analizës së tregut të terminimit të thirrjeve me zë në rrjetet publike mobile**, të cilat janë të publikuara dhe mund të shkarkohen nga ueb faqja e ARKEP: [www.arkep-rks.org](http://www.arkep-rks.org).


Në vijim janë paraqitur përgjigjet e ARKEP në komentet e dërguara nga operatorët TK dhe IPKO.

---

<sup>2</sup> <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AAOJ.L.2015.331.01.0007.01.ENG>

## SHTOJCA I

### Qëndrimi i ARKEP dhe propozimet e operatorëve për tarifat e MTR



## SHTOJCA II

### Përgjigjet e Autoritetit ndaj komenteve/rekomadimeve të TK dhe të IPKO-së

Nr.	Komentet e TK	Përgjigja e Autoritetit
1.	<p>1. Komisioni i ARKEP nuk ka marr parasysh të gjitha çështjet në analizën e tregut dhe të situatës (me theks te veçantë - terminimi përmes OTT aplikacioneve),</p> <p>Në të gjithë raportin, komisioni i ARKEP gjatë analizës së zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës dhe ofertës të terminimit të thirrjeve në rrjetin individual mobil në asnjërin moment nuk analizon impaktin e terminimit të thirrjeve përmes aplikacioneve OTT ku mbi 70% e trafikut realizohet me anë të aplikacioneve që anashkalojnë kontrollin e operatorit mbi terminimin e thirrjeve.</p> <p>Pavarësisht konkluzioneve të ARKEP, është me interes të veçantë për TK në këtë situatë që në kuadrin e rishikimit të tregut aktual, ARKEP mos të dështoj për të njohur si duhet rëndësinë e evolimit të kufizimit konkurrues që vjen nga shërbimet OTT - në veçanti shërbimet e zërit OTT - në analizat e saj dhe definimin e tregut dhe vlerësimit të operatorëve me fuqi të ndjeshme. Aplikacionet OTT luajnë një rol të madh në analizimin e tregut dhe përcaktimin e ndikimit në treg. Aplikacionet OTT mund të konsiderohen si shërbim kanibalizues në sytë e operatoreve, ku të njëjtat kanë qasje shumë të lehtë për shkarkimin dhe përdorimin e tyre nga ana e konsumatoreve fundor, e që kjo bënë presion të vazhdueshëm në zvoglimin e shfrytëzimit të shërbimit me zë në on-net, off-net dhe thirrje ndërkombëtare, gjë që vë në vështirësi realizimet dhe investimet financiare të operatorëve.</p> <p>Duke marr si shkak që komisioni i ARKEP nuk ka marë parasysh/konsideratë asnjëherë aplikacionet OTT siç janë: Viber, WhatsApp, Tango, Skype, Google, Instagram, Facebook, Facetime, etj që</p>	<p>Autoriteti në fillim të procesit të analizës ka bërë përkufizimin e tregut, i cili ka qenë subjekt i analizës, si vijon: <b>“bartja e një thirrjeje me zë përmes një rrjeti mobil nga nyja komutuese (“switching node”) ku është realizuar interkoneksioni (ose mund të jetë realizuar) deri në pikën fundore/terminuese të rrjetit (tutje referuar – Terminimi i thirrjes Mobile)”</b>.</p> <p>Për këtë përkufizim janë pajtuar si TK po ashtu edhe IPKO. Gjthashtu në përgjigjet e marra nga operatorët për pyetësin e dërguar nuk është ngritë si shqetësim ndikimi i OTT-ve në tregun e terminimit të thirrjeve kombëtare. Në kuadër të tyre, vetëm është përmend ndikimi i këtyre aplikacioneve në uljen e trafikut ndërkombëtar.</p> <p>Rregullimi i tregut të terminimit të thirrjeve është i domosdoshëm pasi që për shkak të pengesave teknologjike i njëjti nuk i nënshtrohet presionit të konkurrencës. Pra, anjë operator origjinues nuk mund të terminoj thirrje pa pasur interkoneksion direkt apo indirekt me operatoirin terminues. Kjo gjë vërtetohet nga fakti se që nga korriku 2014 edhe perkundër se MTR në</p>

	<p>shkaktojnë efekte direkte në tërë këtë proces, duke gjeneruar trafik përmes internetit 3G &amp; 4G dhe ngarkon rrjetin dhe krijon humbje të trafikut të terminimit si në atë fiks ashtu edhe në atë mobil. Sa për ilustrim, janë dikund 600,000 përdorues aktiv të Facebook në Kosovë, e po ashtu edhe numër alarmues i përdoruesve të Viber.</p> <p>Sa për ilustrim ju njoftojme se TK ka bashkëpunuar me një institucion ndërkombëtarë duke ndërmarr një hulumtim me rreth 8,500 shfrytëzues të aplikacioneve OTT si dhe institucioni në fjalë ka monitoruar rreth 10,000 thirrje në periudhën prej 7 muajve duke dalur në përfundim se rreth 84% e thirrjeve ndërkombëtare janë riorientuar drejt aplikacioneve OTT, e që për TK paraqet një ndikim jashtëzakonisht të madh në të hyra. Fatkeqësisht, në aspektin legal dhe në fushën e Rregullatorit, ende nuk ka një definim të qartë rreth mënyrës së trajtimit, parandalimit, limitimit, përkatësisht bllokimit të përdorimit të këtyre aplikacioneve si për trafikun ndërkombëtar ashtu edhe atë kombëtar.</p> <p>Gjatë muajit qershor, 2016, është bërë një analizë jashtëzakonisht e rëndësishme nga Fraud Buster dhe Monaco Telecom për periudhën 15 qershor – 30 qershor të këtij viti. Rezultatet e hulumtimit nxorën të dhëna të frikshme të përdorimit të Viber nga konsumatorët e Vala. Nga raportimi në fjalë, rezulton se konsumatorët e Vala realizojnë rreth 3 Milion minuta Viber- Viber në ditë, ndërsa pranojnë rreth 120,000 minuta Viber – In, e që normalisht ky trafik do të ishte pjesë e të hyrave nga trafiku ndërkombëtar, i njohur si incoming.</p> <p>Në një hulumtim të bërë nga Vala me rreth 9,000 respondentë, ka rezultuar se 94% e përdoruesve përdorin vazhdimisht Viber si aplikacion për komunikim.</p> <p>Më tutje, metodologjia e aplikuar Benchmarking (referenca krahasuese në vendet e BE), sipas TK është metodologji e cila mundëson vlerësimin dhe arsyetimin e modelit duke u bazuar në ngjashmërinë mes vendeve krahasuese, ambientin biznesor ku operojnë operatorët, statusi / pronësia</p>	<p>nivel rajonal dhe BE kanë pësuar rënie, një gjë e tillë nuk ka ndodhë në Kosovë .</p> <p>Lidhur me përdorimin e modelit benchmarking për përcaktimin e tarifave Autoriteti ka sqaruar në shtojcën I të draft raportit se bazuar në nenin 40 të LKE <i>Autoriteti mund t'ua imponojë ndërmarrësve që kanë FNT në një treg relevant detyrime për mbulimin e koston dhe kontrollimin e çmimit, duke përfshirë detyrimet për çmimet e bazuara në kosto dhe detyrimet lidhur me sistemet e <u>llogaritjes së koston</u>, për ofrimin e llojeve specifike të interkoneksionit ...</i></p> <p>Marrë parasysh se subjekti i kësaj analize është rregullimi i tregut të terminimit, imponimi i detyrimeve rregullatore është bazuar në nenin 32 të LKE, ku përfshihen edhe detyrimi për kontrollin e çmimeve dhe llogaritjen e koston.</p> <p>Lidhur me këtë, propozimi i Autoritetit është që përcaktimi i tarifave të terminimit të thirrjeve me origjinë kombëtare të bëhet duke u bazuar në modelin “benchmark”. Përdorimin e këtij modeli Autoriteti e bazon në rekomandimin e KE-së të datës 7 Maj 2009, përkatsisht pikës 12 të tij, që trajton rastin e vendeve me kapacitete dhe kohë të kufizuar për ndërtimin e modelit BU LRIC të pastër, duke rekomanduar që këto vende të aplikojnë metoda alternative (si benchmark) por rezultatet e tyre nuk duhet të jenë më të</p>
--	--	---

	<p>e operatoreve dhe praktikat më adaptive që përdoren në vende të ngjashme.</p> <p>Si rezultat, në këtë rast neve mendojmë se modeli i propozuar nga ARKEP për përcaktimin e tarifave të MTR nuk i përgjigjet realitetit, pasi që Kosova nuk është lehtë për tu krahasuar me asnjë nga vendet referente për shkaqe tashmë të njohura nga të gjithë, andaj, propozojmë që vendimet respektive për përcaktimin e operatorëve me FNT në tregun përkatës të merrën pasi që ARKEP të ndërtoj modelin e tyre të kostos të cilat do të jenë të përshtatura me specifikat e tregut kombëtar.</p> <p>TK sugjeron fuqishëm që tarifat dhe kostot relevante duhet të analizohen në mënyrë të detajuar për të siguruar që operatori hipotetik efikas riprodhohet për këtë treg të veçantë (R. Kosovë) dhe kjo do të kërkonte të mirren në konsideratë faktorë të tillë si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tarifat e licences 2G dhe 3G</li> <li>• Kostoja e elementeve të prodhimit (të punës, norma e inflacionit, etj)</li> <li>• Pjekuria e tregut</li> <li>• Numri i lojtarëve (MNOs / MVNO) parashikimet e kërkesës</li> <li>• Topografia e territorit</li> <li>• Shpërndarja gjeografike e trafikut (shkalla psh e nën-shfrytëzimin e rrjetit në zonat rurale dhe kapaciteteve të kufizuara në zonat urbane);</li> <li>• Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit</li> <li>• Profili i rrezikut të investimit</li> <li>• Karakteristikat e ndryshme të tregut (mbulimi i popullsisë, shkalla e penetrimit, numri i konsumatorëve prepaid / postpaid, çmimet me pakicë)</li> <li>• Disponueshmëria e frekuencave</li> <li>• Tranzicioni si proces pas luftës së fundit</li> </ul> <p>TK nuk pretendon se kjo është një listë shteruese me çdo kusht, por, është thjeshtë një pasqyrim i madhësisë së faktorëve që do të shkaktojnë që</p>	<p>larta se tarifa mesatare e terminimit e vendosur nga Autoritetet Rregullatore që kanë aplikuar metodologjinë e LRIC të pastër.</p> <p><b><u>Komenti Nuk Pranohet</u></b></p>
--	--	---

		<p>MTR-ët të ndryshojnë midis vendeve krahasuese. Për shembull, një analizë ekonomike ndërkombëtare ka treguar se faktorë të tillë si ndryshimet në paga dhe terrenit të vendit mund të përbëjnë diferencave deri në 25% më të lartë se një mesatare e MTR Evropiane.</p> <p>Propozimet e ARKEP për rregullimin e tarifave me shumicë ("MTR") vijnë në një kohë kur operatorët e rrjetit mobil ("MNO-të") iu janë nënshtruar investimeve të konsiderueshme, kur kemi parasysh investimet e mëdha të TK (gjatë vitit 2015 ku është investuar mbi €34.6milion, ndërsa, për periudhën Jan-Gusht 2016 mbi €25.6milion) dhe pjesa dërrmuese e investimeve e përbënë segmenti i telefonisë mobile, së bashku me efektet kumulative të kostove gjatë vitit 2015 (shifër e njohur për ARKEP) të blerjes së kapaciteteve frekuencore, pa i lënë mundësi operatorëve t'i kthejnë investimet dhe kostot reale.</p>	
2.		<p>2. Jo barazinë në operim dhe bërjen e biznesit të operatorëve në tregun e Kosovës</p> <p>Komisioni në shumë raste gjatë raportit thekson ndryshimet mes operatorëve me indikacione që i njeh të gjitha problemet, por, në asnjë rast nuk lëshohen në analizimin e gjendjes reale, por, cungohet në 'benchmarking' të BE pa marrë parasysh kostot jo të barabarta të operimit mes operatorëve, barrierat/pengesat e tjera ligjore të cilat ballafaqohet TK si ndërmarrje publike, ndërsa në anën tjetër, operatori konkurent nuk ka bariera të njëjta ligjore për arsye që është biznes privat dhe më fleksibil. Është me rëndësi të përmendet dhe fakti i kostove për shkak të mungesës së kodit shtetëror, ku siç është e ditur, në krahasim nga TK në raport me Monaco Telecom, IPKO si pjesë e Telecom Slovenia nga ku merr edhe kodin nuk ka kosto të larta për shfrytëzim të kodit të tyre dhe duke marr parasysh se Telekom Slovenia është anëtare e BE, operatori në fjalë është pjesë e një tregu më të favorshëm edhe në aspektin ndërkombëtar (tarifa EU Zone) që i lehtëson operimet dhe minimizon kostot e operatorit IPKO.</p>	<p>Nga këndvështrimi i Rregullatorit, të gjithë akterët aktiv në tregun e komunikimeve elektronike funksionojnë në një ambient të barabartë. Nga mungesa e kodit shtetëror ndikohen të gjithë operatorët përfshirë këtu edhe Telekomini e Kosovës.</p> <p>Rregullatori nuk do të leshohet në lehtësirat eventuale që operatorëve mund t'u vijnë nga përdorimi i kodeve shtetërore të vendeve tjera.</p> <p>Autoriteti, nën mandatin që ka, i trajton barabartë të gjithë akterët e tregut të komunikimeve elektronike pavarësisht formave të pronësisë.</p>

	<p>Më tutje, duhet të merret parasysh se TK ka obligime edhe shtetërore të cilat i ka planifikuar në afate 3 vjeçare dhe me ndryshimet e propozuara TK ka mundësi mos t'i arrij obligimet financiare edhe ndaj pronarit/aksionarit, pra, Qeverisë së Kosovës, që do shkaktonte pasiguri financiare, si dhe statusit në pritje rreth privatizimit dhe impaktet e mundshme tek blerësit potencial.</p>	<p><b><u>Komenti Nuk Pranohet</u></b></p>
3.	<p>Propozimi i tarifave të reja shkakton shtrëngim/presion në performancën e TK</p> <p>Duke marrë parasysh të gjitha faktet e lartëcekura tarifave të propozuara për terminimin e thirrjeve mes operatorëve në territorin e Kosovës, TK konsideron se nuk janë tërësisht të bazuara dhe të plota dhe kjo mund të shkaktojë destabilizim të tregut. Andaj, TK propozon një zbritje prej 4.7% në baza 6 mujore të tarifës në mënyrë që edhe tregu, por, edhe performanca e operatorëve të apsorbojë ndryshimin pa ndonjë tundje të madhe.</p> <p>TK është i vetëdijshëm për nevojën e ndryshimeve por nuk mund të pajtohet në asnjë rast për ndryshime kaq drastike të cilat rrezikojnë performancën e korporatës.</p> <p>Në kontekstin e përfitimit të konsumatorëve të industrisë mobile (dhe pozicionimin konkurrues), mënyra më e mirë e balancimit (në mesin etributeve të tjera) është edhe duke balancuar çmimin me investime, për të ofruar shërbim më të mirë të rrjetit, në drejtim të mbulimit, kapaciteteve, besueshmërisë dhe shpejtësisë.</p> <p>Për më tepër, në raport nuk sqarohen thellësisht marrëdhëniet komplekse mes MTR dhe çmimit fundor në tregun me pakicë, pasi që konsiderohet vetëm rasti se një reduktim në MTR do të çon në një reduktim në tarifën në tregun me pakicë. Në veçanti, ARKEP thekson se propozimi për</p>	<p>Propozimi lidhur me përcaktimin e shkallës së uljes së tarifave është bazuar në ligjin për komunikime elektronike përkatësisht nëni 3 paragrafi 1 që parashikon se:</p> <p><i>“Rregullimi i aktiviteteve të komunikimeve elektronike duhet të bazohet në parimet e .., neutralitetit teknologjik, ekuivalencës funksionale, proporcionalitetit, rregullimit minimal të domosdoshëm, sigurisë ligjore në një treg dinamik, zhvillimit ekonomik, <b><u>duke siguruar konkurrencë efektive, mbrojtje të të drejtave të konsumatorit, objektivitet të kriterëve, kushteve dhe procedurave rregullatore, transparencë dhe mosdiskriminim.</u></b>”</i></p> <p>Bazuar në Parimin Pala thirrëse Paguan (Calling Party Pay-CPP), tarifa e terminimit është kosto direkte për operatorin e thirrjeve origjinuese në shkuarje (outgoing off-net calls) dhe e cila i faturohet konsumatorit fundor. Zbritja e kësaj tarife ulë kostot për operatorin origjinues, e cila më pastaj do të stimulonte uljen e tarifave me pakicë.</p>



reduktimin e përshpejtuar të MTR do të çojë në një reduktim në tarifat me pakicë. Si rezultat, sipas TK kjo nuk parashikon se domosdoshmërisht kjo ulje do të çojë në promovim të efikasitetit të konkurrencës afat gjatë me qëllim që perfitimet e përdoruesve të jenë maksimale. Për më shumë, ka evidenca teorike dhe empirike, të referuara si efekt 'waterbed'<sup>3</sup>, e cila hedh poshtë gjetjet e ARKEP.

Gjithashtu, duhet të merret parasysh se tregu i mobil në Kosovë është i bazuar fuqishëm në 'pre-paid', në krahasim me 'post-paid', përderisa, TK ("VALA") deri në fund të vitit 2015, për shërbimet pre-paid është e përbërë prej më shumë se 96% të abonentëve, që paraqitet në figurën më poshtë:

	Nr. i abonentëve	Përqindja
Pre-paid	950,540	96.38%
Post-paid	35,751	3.62%
<b>Totali</b>	<b>986,291</b>	<b>100.00%</b>

Është e argumentueshme se tërheqja e klientëve me parapagim / pre-paid në rritjen e operatorëve është e lidhur ngushtë me nivelin e MTR: klientët pre-paid, duke mos qenë të detyruar të paguajnë një tarifë abonimi mujor, të njëjtit nuk gjenerojnë të hyra për operatorin vetëm me rastin e Top-Up/mbushjeve, përderisa nuk përdoren për shërbimet e operatorit, si dhe në momentin kur ata pranojnë thirrje ku operatori shfrytëzohet si terminues i thirrjes.

Të hyrat vetëm nga TopUP nuk janë substanciale dhe incentiv i mjaftueshëm për operatorin që të rris numrin e konsumatorëve prepaid për shkak të zvoglimit të të hyrave nga MTR.

Sa i përket strukturës së konsumatorëve ARKEP është në dijeni se tregu i telefonisë mobile në Kosovë dominohet nga konsumatorët me parapagim, e cila vjen si rezultat i ofertave në raport me përmbushjen e nevojave për komunikim dhe mundësisë së përballimit të pagesës nga ana e konsumatorëve.

Sa i përket pagesës së mirëmbajtjes mujore, pagesa e kësaj tarife tek konsumatorët me parapagim bëhet përmes komunikimit dhe për këtë shkak këto tarifa janë më të larta në raport me ato postpaid.


Nëse analizohet bilanci i trafiku të shkëmbyer në mes të operatorëve, kohëve të fundit vërehet një ngushtim i tij, me tendencë e cila mund të shkojë drejt një shkëmbimi tërësisht të barabartë ku ekzistimi i MTR do të ishte e papërfillshme. Ulja e MTR –së nxitë konkurrencën në mes të operatorëve që të jenë më inovativ në ofrimin e pakove më atraktive për konsumatorët pavarësisht se trafiku zhvillohet on-net apo off-net.

Analizat mikroekonomike janë të dobishme për qëllimet e brendshme të operatorit, për të ndërtuar strategji biznesi dhe marketingu. Ndërsa indikator i dalë nga analiza e TK se

<sup>3</sup> Definicioni 'waterbed' nga Schiff (2007) ku thotë se: 'efekti ku rregullimi i një prej çmimeve të një firme multi-produkt shkakton një ose më shumë nga çmimet e saj, pra të tjera të parregulluara për të ndryshuar si rezultat i sjelljes për maksimizimin e fitimit të firmës' (fq.1). Schiff (2007), *The Waterbed Effect and Price Regulation*, Institute of Economic Research, Hitotsubashi University

	<p>Shiquar në profilin e origjinimit të thirrjeve në mes të klientëve pre-paid dhe klientëve post-paid, kemi hasur në ndryshime substanciale ku mbi 2/3 e origjinimit të thirrjeve realizohen nga klientët post-paid krahasuar nga 1/3 e klientëve pre-paid.</p> <p>Pra, është e arsyeshme të supozohet se nga klientët pre-paid margjinat e fitimit janë të lidhur ngusht me në thirrjet përbrenda rrjetit dhe në veçanti me një nivel të arsyeshëm të MTR, gjegjësisht, rasti i biznesit për këta konsumator është fort i lidhur me margjinat e arritura nga thirrjet brenda rrjetit në veçanti me një nivel të arsyeshëm të MTR, gjë që bën biznesin prepaid ekonomikisht të qëndrueshëm.</p> <p>Në përlllogaritjen e 19 mujorve pasues për gjenerimin e të hyrave kjo ulje e çmimit të propozuar nga ARKEP nënkupton se Telekom i Kosovës do të duhet të gjeneronte elasticitetin për të rritur trafik prej 32.18%. Një ulje e tillë do të duhet për të qenë unitar vetëm nëse kjo ulje do të pasonte një rritje prej 32.18% dhe kjo rritje minimale e trafikut pothuajse është e pa-arritshme dhe e pa-justifikuar mirë. Lidhur me tarifën e MTR gjatë analizës mund të shtojmë se vendet si Britania e Madhe dhe Gjermania kanë pësuar ngritje të tarifës. Gjithësesi, MTR të disa shteteve janë më të larta se tarifa aktuale dhe mbesin me të larta se tarifa e propozuar nga ARKEP. Shtetet që kanë tarifa më të larta janë Serbia me 2.8483Euro cent me 9.3m abonent, Irlanda me 2.6Euro cent me 4.8m abonent, Litenshtajni me 7.3487Euro cent me 11.8m abonent, ndërsa më e lartë se tarifa e propozuar nga ARKEP janë shtetet si Gjermania me 1.72Euro cent me 112m abonent, Finlanda me 1.87 Euro cent me 9.4m abonent dhe Mali i Zi me 1.9Euro cent me 1m abonent. Ndërsa, tregu mobil i Kosovës me 1,762,611 abonent (sipas TM2-2016 raporti ARKEP), me analizën e bazuar në thirrjet 19 mujore del në pah se abonentët tanë mesatarisht flasin 4.54min në ditë, ndërsa shtetet tjera duke përfshirë edhe shtetet e rajonit kanë mesataren shumë më të lartë se Tregu i Terminimit Mobil në Kosovë.</p>	<p>abonentët e tyre flasin mesatarisht nga 4.54 min/ditë, që konsiderohet të jetë shumë më e ulët se mesatarja e vendeve të tjera përfshirë ato të rajonit, tregon më së miri nevojën për përcaktimin e një tarife me shkallë të konsiderueshme rënëse, e cila do të kontribonte në rritjen e mesatares së komunikmive përmes rrjetit mobil.</p> <p>ARKEP sqaron se rregullimi i tarifave është vetëm për trafikun e origjinuar brenda Kosovës (kombëtar) dhe jo për trafikun e origjinuar jashtë saj (ndërkombëtar). Kjo është specifikuar qartë edhe në dispozitivin e draft vendimeve për OFNT.</p> <p><b><u>Komenti Nuk Pranohet</u></b></p>
--	--	--

## TRAFIKU 2015 - 2016



### Përfundim:

Nisur nga përshkrimi i gjendjes se lartcekur, TK konsideron se një zbritje për MTR-së me një shkallë kaq të lartë, do kishte efekt domino dhe si e tillë do krijonte një situatë dhe sjellje të operatorëve shumë më ndryshe. Ndryshimet e tilla drastike, ndonëse sjellin lehtësira në komunikim për klientët fundor (por jo domosdoshmërisht), të njëjtat do të jenë të pa përballueshme për TK si operator publik.

Do ishte krejt normale dhe e pranueshme për TK ky propozim nga ARKEP, nëse operatorët do kishin statutin pronësor të njëjtit, apo edhe te ngjashëm. Burokracia në vendimmarrje, ligjet e aplikueshme për institucione publike, e bën TK të jetë në një situatë diskriminuese dhe krijon vështirësi në të bërit biznes. Ndonëse mund të thuhet se klima biznesore është e njëjtë, lojtarët në fushë nuk kanë rregulla të njëjta në këtë lojë, veçanërisht në aspektin kohor të ndërmarrjes së veprimeve për shkak të afateve kohore të ndikura veçmas nga ligji i prokurimit publik. (Edhe

pse ky fakt nuk mund t'i atribuohet ARKEP).

Qëllimi i ARKEP në këtë Draft për këshillim publik, "Terminimi i thirrjeve me zë në rrjetet individuale mobile", është i mirë dhe duhet kuptuar si tendencë në rregullimin tregut të telekomunikimeve, por, mbetet që të merr për bazë argumentet e palëve të përfshira në këtë proces, e sidomos palës që mund të dëmtohet (pa fajin e saj).

Një ulje më e kontrolluar, më e lehtë e çmimorës në mes operatorëve për MTR do ishte më e pranueshme dhe më lehte e adaptueshme për të gjithë.

Andaj, luteni që propozimi, qëllimi i ynë (i drejtë) të merret në konsideratë dhe në asnjë formë si dëshirë për të krijuar favore Telekomit të Kosovës.

TK duke marrë për bazë të gjitha më sipër propozon si më poshtë:

- i. Komisioni të ri-përpiloj raportin ku do marrë parasysh të gjitha elementet (OTT dhe kostot);
- ii. Të caktoj tarifat e reja pasi Kosovës t'i atribuohet kodi shtetëror dhe ARKEP të ndërtoj modelin e tyre të kostos të cilat do të jenë të përshtatura me specifikat e tregut kombëtar; ose
- iii. Në rastin më të 'keq', në rast se nuk merren parasysh propozimet si më lartë, tarifat e reja të jenë:

Periudha	1 Janar 2017	1 Korrik 2017	1 Janar 2018	1 Korrik 2018
MTR ne EURcent/min	2.19	2.09	1.99	1.90

Ju faleminderit për bashkëpunim.

	<p>Sqarim shtesë: Në dokumentacionin e ofruar të analizës dhe vendimeve, TK nuk ka hasur në sqarim të përjashtimit të terminimit të thirrjeve kur origjina është jashtë Kosovës. Tregu i definuar këtu nuk përjashton këtë trafik. Përjashtim bënë një referencë të obligimi për kontrollin e çmimit, ku neve si operator na jipet në diskrecion negocimi i çmimit MTR për thirrjet e origjinuara jashtë vendit. Përndryshe obligimet tjera që dalin nga këto vendime nuk është përshkruar në mënyrë eksplicite se përjashtohet ky trafik. Në mungesë të kodit dhe në bazë të kufizimeve që kemi në raport me MTI, terminimi i thirrjeve në 3774x, kur origjina është jashtë Kosovës, i është dhene MTI-së në bazë të ekskluzivitetit. Andaj, është e domosdoshme të sqarohet dhe të rezervohet e drejta e përjashtimit të këtij skenari nga të gjitha obligimet që rezultojne për terminimin e thirrjeve me adresë 377.</p>	
--	--	--

Nr.		Komentet e IPKO	Përgjigja e Autoritetit
1.		<p>1.1 Komenti: Në faqen 3/11 të Draft Shtojcës I, ARKEP deklaroi se BEREC kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile dhe se publikimet bëhen çdo gjashtë muaj dhe publikimi i fundit është në Janar 2015.</p> <p><b>Propozimi:</b> Të fshihet ky paragraf, sepse BEREC nuk ka publikuar asnjë raport lidhur me tarifat mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile në janar 2015, por BEREC ka publikuar një raport në qershor të vitit 2015 për tarifat mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile dhe fikse.</p>	<p>Pas draftit të parë, të bërë nga ARKEP, të dhënat në tabelë janë përditësuar ndërsa përshkrimi në tekst ka mbetur ai nga drafti i parë.</p> <p>Të dhënat në figurën 2 të shtojcës në fq. 3/11, janë për periudhën korrik 2015, të marra nga Raporti i BEREC, i publikuar në dhjetor të vitit 2015, i titulluar: "Termination rates at the European level"<sup>4</sup>,</p> <p>Riformulohet paragrafi si në vijim :</p> <p><i>BEREC kryen publikime periodike të tarifave mesatare të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile çdo gjashtë muaj dhe publikimi i fundit është në dhjetor 2015 me të dhënat e muajit korrik 2015, ...</i></p> <p><b><u>Komenti Pranohet</u></b></p>
2.		<p>1.2 Komenti: Në faqen e njëjtë 3/11 të Draft Shtojcës I, ARKEP deklaroi se publikimi i fundit i BEREC është në janar të vitit 2015, andaj edhe draft raporti dhe vendimi i ARKEP-it është bazuar në raportin e BEREC të vitit 2015. Ndërsa IPKO Telecommunications LLC komentoi se raporti i BEREC i vitit 2015 është ndryshuar me dy raporte vazhduese dhe atë një në dhjetor të vitit 2015 për korrik të vitit 2015 dhe me raportin me të ri të majit 2016 për janar të vitit 2016.</p>	<p>Për këtë koment, pjesërisht vlen përgjigjeja e dhënë në komentin paraprak.</p> <p>Njëkohësisht, duhet theksuar se draft analiza ka marrë formën përfundimtare nga DKE dhe është propozuar për mbledhjen e Bordit të ARKEP në maj 2016, kur ka mundur që të jetë publikuar raporti i fundit</p>

<sup>4</sup> [http://berec.europa.eu/eng/document\\_register/subject\\_matter/berec/reports/5591-termination-rates-at-european-level-july-2015](http://berec.europa.eu/eng/document_register/subject_matter/berec/reports/5591-termination-rates-at-european-level-july-2015), e kontrolluar në shkurt 2016

		<p>Propozim: Të fshihet ky paragraf dhe të zëvendësohen të gjitha të dhënat me raportin e BEREC të nxjerrë në maj të vitit 2016 për janar të vitit 2016 sepse ky raport është brenda intervalit kohorë kur draft Shtojca I e ARKEP-it është draftuar dhe parashtruar.</p>	<p>i BEREC. Pas analizimit të këtij publikimi vërehet se për të dhënat e referuara nuk ka ndonjë ndryshim domethënës, konsiderojmë se nuk është e nevojshme të revidohet draft analiza për këtë pjesë.</p> <p><b><u>Komenti nuk pranohet</u></b></p>
		<p>1.3 Koment: Draft Shtojca I e ARKEP-it është publikuar më 1 gusht 2016 dhe vazhdimisht në mënyrë jo të rregullt ka marrë në konsiderim raportin e BEREC të vitit 2015 IPKO Telecommucnaitions LLC konsideron se kjo nuk është në pajtim me nenin 1.3 dhe nenin 3.6 të Rregullores së ARKEP-it 040/B/14 për Analizat e Tregut si dhe ligjet e aplikueshme të veqanta dhe të përgjithshme të Republikës së Kosovës.</p> <p>Propozim: Për shkak të faktit se BEREC ka nxjerrë raport të përditësuar në muajin maj 2016 dhe determinoi një mesatare të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile për 36 shtete dhe ndaras për 28 shtete anëtare të BE-së, IPKO Telecommunications LLC propozon që i gjithë dokumenti të merr në konsiderim raportin e BEREC BOR (16) 90 të majit të vitit 2016 dhe tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile nga dokumenti i Cullen International CTTEEU20160145-July 27, 2016 duke fshirë dhe larguar të gjitha referencave të bëra në raportin e BEREC të vitit 2015.</p>	<p>Dokumenti i Cullen International CTTEEU20160145-July 27, 2016, është një dokument i publikuar pasi që draft analiza e tregut i ka kaluar të gjitha procedurat në mbledhjen e Bordit të ARKEP, kur edhe është marrë vendimi për ta prezentuar për këshillim publik. Ndërsa, lidhur me raportin e fundit të BEREC, BOR (16) 90, i publikuar në 2016, u dhanë sqarime në përgjigjen paraprake.</p> <p><b><u>Komenti nuk pranohet</u></b></p>

4.		<p>1.4. Koment: Draft Shtojca I e ARKEP-it referohet vendimit 644 të datës 27 maj 2015.</p> <p>Propozim: Ky referim do të duhet të fshihet për shkak se kjo analizë ka filluar me vendimin e ARKEP-it nr. 848, dhe nëse ky referim mbetet si i tillë sigurisht që do të themelon shkelje të nenit 3.9 të Rregullores të ARKEP-it 040/B/14 për Analizat e Tregut.</p>	
		<p>2.1. Koment: Draft Raporti i ARKEP-it në faqen 5/52 i referohet vendimit nr. 644 të datës 27.05.2015 dhe pyetësorit të parashtruar nga IPKO Telecommunications LLC më datën 17.08.2015</p> <p>Propozim: Kjo reference do të duhej të fshihej si në këtë dokument ashtu edhe në të gjitha dokumentat lidhur me këtë çështje, sepse analiza aktuale është inicuar me vendimin 848, dhe nëse referimi në vendimin 644 mbetet, do të themelon shkelje të nenit 3.9 të Rregullores së ARKEP-it 040/B/14 për Analizat e Tregut. Për më tepër ARKEP në pajtim me nenin 3 të Rregullores së përmendur më lartë do të duhej që gjithashtu të trajton situatën aktuale faktike të ndikimit të OTT-ve në këtë treg, andaj IPKO gjithashtu propozon që çështja e OTT-ve të përfshihet në këtë analizë për shkak të ndikimit të jashtëzakonshëm në këtë treg.</p>	<p>Në nenin 31 të LKE, përcaktohet se: "Analiza e tregut duhet të bëhet nga Autoriteti. Procedura e analizës së tregut duhet të iniciohet me një vendim të paraprak të Autoritetit".</p> <p>Andaj, nëse fshihet ky nen siç pretendon IPKO do të bëhet shkelje e LKE, pasi që LKE obligon Autoritetit të fillojë procesin e analizes se tregut me vendim.</p> <p><b><u>Komenti nuk pranohet</u></b></p>
		<p>2.2 Koment: Draft Raporti i ARKEP-it në faqen 40/52 konfirmon që shkalla e zvogëlimit të tarifës së terminimit është më e ngadalshme se mesatarja e BE-së.</p> <p>Propozim: ARKEP do të duhej të vepronte mbi gjetjet e saja dhe në vënd të 1.74 eurocent/minute duke filluar nga janari 2017, ARKEP do të duhej të propozonte që tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetet mobile nga janari 2017 të ndryshohej dhe të jetë 1.110 eurocent/minute, gjithashtu duke marrë në konsiderim</p>	<p>Është praktikë standarde e rregullatorëve që të përdorin "glide path" me rastin e rregullimit të reduktimit të tarifave të terminimit për një periudhë të caktuar kohore.</p> <p>Është në diskrecion të rregullatorit të përcaktoj elementet për "glide path" si : kohëzgjatja, norma e zbritjes, numri i</p>



		<p>se kjo tarifë nuk është zvogëluar që nga korriku i vitit 2014 dhe faktin se zvogëlimi i mesatares në BE (tabela 1) ka pasë zvogëlim drastik si dhe do të ishte në pajtim me Rregulloren EC 2015/2352 të theksuar nga vetë ARKEP dhe se e njëjta ka vendosur që lartësia e lejuar e kësaj tarife nuk mund të jetë me e lartë se 0.0114 për minutë që nga 30 prilli 2016.</p> <p>IPKO Telecommunications LLC gjithashtu thekson se nëse ARKEP krahason zvogëlimin e tarifës që nga korriku 2014, janari 2015, korriku 2015, janari 2016 në 28 shtetet anëtare të BE-së rezulton se zvogëlimi arriti 8% për 3 periudhat e matura dhe vlera e kalkuluar nga ARKEP do të duhej të rezultonte për 4 periudhat e ardhshme janar 2017, korrik 2017, janar 2018 dhe korrik 2018 në 0.706 euro/cent/minute për korrik 2018. Pra, përsëri çmimi që pretendohet nga ARKEP prej 1.14 euocent/minute në korrik 2018, do të jetë sigurisht shumë më i lartë krahasuar me çmimin prej 0.706 euocent/minute që do të arrihet në BE duke marrë parasysh parashikimin prej 8% rënie në korrik 2018. Në rastë se ARKEP nuk merr në konsiderim këtë propozim, dhe nuk ndryshon çmimin nga 1.74 në 1.110 euocent/minute duke filluar nga janari I vitit 2017 atëherë në korrik 2018 do të jetë me një diferencë ekstreme prej 62% më të lartë se në shtetet anëtare të BE-së të cilat në korrik të vitit 2018 do të kenë vlerën prej 0.706 euocent/minute. Andaj, IPKO Telecommunication LLC propozon 1.110 eurocent/minute duke filluar nga janari i vitit 2017 me 13% zvogëlim për të arritur një çmim më të përafërt me shtetet e BE-së.</p>	<p>periudhave etj.</p> <p>Metoda “Glide-path” e propozuar nga ARKEP konsiderohet të jetë më e arsyeshme, pasi që është në funksion të ruajtjes së stabilitetit të tregut, duke u dhënë mundësinë operatorëve t’u përshtaten kushteve të reja, dhe t’u shmangen rrezikut të çrregullimit të tregut që do të mund të vinte qoftë nga një rënie e ngadalëshme apo nga një rënie drastike e tarifës.</p> <p>Për më tepër, rregullorja e Bashkimit Evropian ka përcaktuar tavanin e tarifës së terminimit të thirrjeve mobile 1.14 €cent, të cilën ne pretendojmë t’a arrijmë për 1.5 vite.</p> <p><b><u>Komenti nuk pranohet</u></b></p>
		<p><b>2.3. Komete dhe propozime për shkak të influencës faktike të Viber-it në Draft Raportin për Analizën e Tregut dhe Përcaktimin e Operatorëve me Fuqi të ndjeshme në Treg, për terminimin e thirrjeve me zë në rrjetet individuale mobile, Draft Shtojcës I dhe Draft Vendimeve referuar Vendimit të ARKEP-it 848</b></p>	<p>Çështjen e trajtimit të Viber, ARKEP e vështron me kujdes pasi që ky është një problem ndërkombëtar. ARKEP do të përcjellë me vëmendje rekomandimet dhe vendimet e Komisionit evropian dhe të BEREC.</p>

	<p>Propozim: ARKEP do duhej të vepron brenda këtij procesi, për shkak të konkurrencës jolojale që është duke bërë Viber përmes ofrimit të shërbimeve falas, rrjedhimisht duke bërë tregun e telefonisë mobile të Kosovës tregun më problematik por edhe duke pasë parasysh se ky treg është kryesisht treg -prepaid-, andaj është e një rëndësie të madhe që të kemi bariera më të ulëta, respektivisht implementim më të shpejtë të tarifave më të ulëta për terminimin e thirrjeve në telefoni mobile duke i dhënë operatorëve të licensuar mundësi fer për të ofruar oferta më atraktive përdoruesve në Republikën e Kosovës, rrjedhimisht edhe mundësimin e mbajtjes të trafikut në rrjetet e telefonisë mobile me zë.</p>	<p><b><u>Komenti nuk pranohet</u></b></p>
--	--	---